

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Albanian Flight Training Academy”SHPK**

**KREU I
Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën 30 Shtator 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë) shtetasit:

EDUARD MOLLA, i biri i Fadil, i datelindjes 40.10.1955, lindur ne Koplik dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr. Personal F510040211.

FENG NAN i datelindjes 13/04/1978 lindur ne GANSU, ne Republiken e Kines , shtetase kineze , madhor e me zotesine e plote per te vepruar mbajtes i Leternjoftimit nr. EE5995685

KANG YANQING , i datelindjes 06.06.1983 , lindur ne HEBEI, ne Republiken e Kines, shtetas kinez , madhor me zotesine e plote per te vepruar mbajtes i Leternjoftimit me nr.EH3276643

LI HUIDONG, i datelindjes 27.12.1975, lindur ne HEBEI, ne Republiken Kineze, shtetas kinez, madhor me zotesine e plote per te vepruar mbajtes i Leternjoftimit nr.EB8007964


WANG HONGXU, i datelindjes 19.09.1973, lindur ne HEBEI, ne Republiken Kineze, shtetas kinez, madhor me zotesine e plote per te vepruar mbajtes i Leternjoftimit me nr.EA3661385

ne cilesine e "Ortakeve Themelues", me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", të ndryshuar, vendosen te themelojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin **“Albanian Flight Training Academy” SHPK.**

**KREU II
Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

**Neni 1
EMRI**

- 1.1** Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes “shoqeri me pergjegjesi te kufizuar” dhe mban emrin **“Albanian Flight Training Academy” SHPK, shkurt AFTA.**
- 1.2** Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Shoqëria mund të shtohet me ortak te tjere vendas dhe/ ose te huaj ne çdo kohe në përputhje me legjislacionin përkatës ne fuqi.



Neni 2 Objekti

Shoqëria "Albanian Flight Training Academy" SHPK do të ketë objekt veprimtarie:

1-Planifikim dhe ndertim aeroporti, aerodrome civile, fusha fluturimi për qëllime të aviacionit civil. Projektim. Kërkim dhe zhvillim të komunikimit në fushën e aviacionit civil. Terrene të reja lokale dhe rajonale duke përfshirë dhe infrastrukturën përkatëse (si zyra për personelin, vendparkim për automjete, hangar për mirëmbajtje të avioneve, salla mbledhjesh, trajnimi, mjedise clodhëse, bar- restaurant, etj) për veprimtari të aviacionit civil në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtaritë në fushën e transportit ajror civil. Shkollim të aplikantëve për trajnime për licensimin e pilotëve me license private dhe/ ose komerciale. Qiradhënie avioni. Fluturime ajrore jo komerciale. Veprimtari kërkimore dhe zhvillimi, shitje dhe shërbim mbështetës për shkencën dhe teknologjinë e produkteve të Teknologjisë së Aviacionit si software dhe hardware. Shitje avionësh, qiradhënie, mirëmbajtje; Import dhe eksport të pjesëve të këmbimit për to. Konsultime teknike për aviacionin civil. Shitje dhe qiradhënie të materialeve të aviacionit. Projektim, shitje, ofrim të shërbimeve teknike për avion nje dhe shumë funksional, robotë inteligjent, drone dhe pjesë, informacion për pajisjet e terminalit të aeroportit. Shërbime për mbikqyrje, monitorim, hartografi, reklama ajrore me mjete fluturues të lejuara në pronësi të shoqërisë dhe/ ose të marra me qira. Importim dhe eksportim të mallrave, teknologjisë, ndërmjetësime si komisioner (duke përjashtuar mallrat dhe teknologjinë e ndaluar sipas legjislacionit.

2-Shoqëria mund të marrë persiper çdo aktivitet tjetër të lidhur me sa më sipër dhe të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 3 Kohëzgjatja


- 3.1 Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Ortakëve, sipas kuorumit përkatës vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqëria "Albanian Flight Training Academy" SHPK gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKR-se.

Neni 4 Zyra Qendrore

- 4.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rr.Grigor Durrsaku, Lagja nr.3, Pallati FLY, Zona Kadastrale nr.8512, Durrës.**
- 4.2 Gjate veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridiksionit të vendit përkatës.

KREU III

Neni 5



Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise është **100.000Lek** (njqind mije lek), i ndare ne 5 kuota si me poshte. Kontributet e ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.
- 5.2 Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë eshte ne raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes te seicilit ortak, llogaritet ne raport me seicilin kontribut, e paraqitur ne menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:

Nr.	Emri i Ortakeve	Kuota	Kontributi i ortakeve ne kapital (leke)	Perqindja ne kapital
1	FENG NAN	1	4.000	4%
2	KANG YANQING	1	50.000	50%
3	LI HUDONG	1	20.000	20%
4	WANG HONGXU	1	20.000	20%
5	EDUARD MOLLA	1	6.000	6%
Totali		1	100.000	100 %

- 5.3 Kontributet sa me siper jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakeve te te shoqerise.

Neni 6

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar


- 6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.
- 6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh qe te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji per Shoqerite Tregtare.

KREU IV

Neni 7

Transferimi i Kuotave

- 7.1 Transferimi (perfshire shitje dhe ose dhurimin dhe ose cedimin dhe ose kalimin) inter vivos te kuotave te shoqerise tek pale te treta i nenshtrohet te



drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere ekzistues, te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te parashikuara ne nenin 7.2 me poshte.

- 7.2 Ne rast se nje ortak (ketej e tutje i quajtur Ofruesi) kerkon te transferoje disa ose te gjitha kuotat ose kontributet e zoteruara prej tij ne shoqeri, ortaket e tjere (ketej e tutje te quajtur Ortaket e tjere) gezojne te drejten e parablerjes mbi kuotat qe ofrohen per transferim (ketej e tutje te quajtur Kuotat e ofruara), sipas afateve dhe kushteve te meposhtme:
- a. Ofruesi do tu dergoje fillimisht ortakeve te tjere ekzistues nje njoftim me shkrim (poste rekomande) ku te percaktohet numri i kuotave te ofruara, si dhe cmimin e kuotave te ofruara, emrin e bleresit dhe kushtet e tjera kontraktuale te transferimit (ketej e tutje referuar si oferta) duke ftuar se pari ortaket ekzistues te blejne keto kuota te ofruara.
 - b. Ortaket e tjere kane te drejte te blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, ne perpjestim me perqindjet e zoteruara e zoteruara, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati 30 ditor pas marrjes se njoftimit te ofruesit me poste rekomande.
- 7.3 Ne rast se nje apo disa nga ortaket ekzistues nuk pergjigjen gjate afatit te mesiperme apo pergjigjen ne menyre negative, atehere ofruesi eshte i lire ne transferimin e kuotave ne favor te paleve te treta pa kufizim, me kushte te njejta si ato te parashikuara ne oferten e mesiperme.
- 7.4 Parashikimet sa me siper nuk zbatohen ne rastin kur kuotat transferohen ndermjet ortakeve ekzistues apo tek personat e paralindur apo paslindur ne vije te drejte te ortakeve ekzistues (femije, bashkeshorte).

Neni 8

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit


- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë nga shoqëria likuidimin e saj, ne vlere te percaktuar nga ekspert perkates.

KREU IV

Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme




4

- 9.1** Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- a. percaktimi i politikave tregtare;
 - b. ndryshime te Statutit;
 - c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
 - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
 - f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
 - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
 - h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
 - i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
 - j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
 - l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
 - m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
 - n. ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht."

- 9.2** Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e permendura ne pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates te derguar me thirrjen e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 9.3** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e minorances sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi nëpërmjet një njoftimi me leter rekomande me njoftim marrje te derguar ne adresen e ortakeve apo poste elektronike (E.mail) (adresa te depozituara rregullisht nga ortakët prane administratorit dhe E.mail te pasqyruar ne ekstraktin e shoqerise ne te dhenat vullnetare te tij te pakten 7 (shtatë) dite perpara mbledhjes). Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga te gjithë ortakët qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise.
- 9.4** Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permbaje ne menyre te qarte daten, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës te mbledhjes, se bashku me dokumentacionin perkates dhe do t'u dergohen te gjithë Ortakeve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.



Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejta procedure njoftimi qe pershkruhet me siper.

Neni 10 Kuorumi i nevojshem

- 10.1** Në rastin e marrjes së vendimeve te zakonshme, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë dhe janë të pranishëm qoftë dhe nepermjet perfaqesuesve te autorizuar, ortakët me të drejtë vote, te cilet zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit te shoqerise.
- 10.2** Në rastin e marrjes së vendimeve te jashtezakonshme, qe kerkojne nje shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë dhe janë të pranishëm qofte dhe nepermjet perfaqesuesve te autorizuar, ortakët me të drejtë vote, te cilet zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit te shoqerise.
- 10.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

- 11.1** Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme me ane te votes pro te nje shumice prej 3/4 të ortakëve pjesmarres ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme rregullisht te mbledhur për ceshtje te rendesishme qe kane te bejne me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2** Asambleja e Përgjithshme mund te marre vendime te zakonshme me anen e votes pro te shumices te ortakeve pjesmarres ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme, rregullisht te mbledhur, dhe vecanerisht mbi ceshtjet e meposhtme:
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

- 11.3** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.4** Kryetari i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të jetë administratori i shoqërisë i cili do të drejtojë mbledhjen dhe asambleja e përgjithshme në çdo mbledhje të saj do të emerojë me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës edhe një person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.
- 11.5** Çdo vendim i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të regjistrohet në proces-verbal, i cili do të mbahet në përputhje me nenin 90 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 12 Votat e Ortakëve

- 12.1** Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi.
- 12.2** Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.


KREU V Administratori

Neni 13 Emërimi i Administratorit

- 13.1** Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë 5 (pesëvjeçare), në pajtim me parashikimet e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakëve në Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 13.2** Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë “**Albanian Flight Training Academy**” SHPK:

Eduard MOLLA, i datelindjes 40.10.1955, lindur në Koplik dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesinë e plote për të vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr. Personal F510040211, **per nje afat 5 vjecar, nga momenti i regjistrimit te ketij fakti prane OKB.**

Neni 14



Kompetencat e Administratorit


- 14.1** Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar në fuqi.
- 14.2** Pa u kufizuar sa më sipër, në mënyrë të veçantë, Administratori ka këto kompetenca:
- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë për sa i përket administrimit të zakonshëm;
 - (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
 - (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
 - (iv) do të urdherojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë – duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
 - (v) do të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9723, datë 3 Maj 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar;
 - (vi) do t’i raportojë Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - (vii) do të përgatisë të gjitha planet për zhvillimin dhe operimin e shoqërisë sipas objektit;
 - (xii) do të marrë në punë, emerojë, shkarkojë të punësuar të Shoqërisë për çdo nivel, përfshirë edhe të punësuar me kohë të pjesshme, konsulentë, agjente, do të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do të përcaktojë shpërblimin e tyre;
 - (viii) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke pasur parasysh respektimin në çdo rast të kufizimeve të parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhëna me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
 - (ix) Do të administrojë adresat dhe kontaktet e ortakeve (tel, e.mail). Në çdo rast ortaket janë të detyruar që menjëherë pas çdo azhurnimi të kontakteve të tij (nr.tel, email, adrese shtepie) të njoftojë administratorin me shkrim, në të kundërt mban përgjegjësi për çdo dëm të shkaktuar nga mosnjoftimi në kohë.

Neni 15

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. jep dorëheqje nga detyra duke njoftuar shoqërinë;
4. vdekjeje;



Neni 16
Kufizimet në Veprimet e Administratorit

- 16.1** Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë, në bazë të kuorumit të kërkuar, autorizo lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë QKB.


KREU VI
Prishja dhe njoftimet

Neni 17
Shkaqet e prishjes së shoqërisë

17.1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;
 - d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
- 17.2** Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 17.3** Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKB-se.



Neni 18 Njoftimet


- 18.1** Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 18.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortak. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 19 Te Ndryshme

- 19.1** Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vlerën e saj.
- 19.2** Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohë pas kohe gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 19.3** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 19.4** Në fund të cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 19.5** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

Neni 20 Dispozita perfundimtare

- 20.1** Ky statut përben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose teresisht dhe të zevendesohet me



nje statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.

20.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.


Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare, me permbajtje dhe vlera te njejte juridike, ne gjuhen Shqip dhe u nenshkrua nga palet pa asnje rezerve.

ORTAKU THEMELUES


EDUARD MOLLA




FENG NAN



KANG YANQING



LI HUIDONG



WANG HONGXU

